



Nr. 871 prot

Datë 30.09/2020



Nr. 1559 prot

Datë 01/10/2020

Marrëveshje bashkëpunimi
Midis
Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë
Dhe
Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë

Universiteti Mesdhetar i Shqipëris dhe Univerisateti "Ismail Qemali" Vlorë, të nisura nga dëshira për të vendosur dhe thelluar bashkëpunimin dypalësh ndërmjet tyre, lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit akademik dhe provimin e mirëkuptimit mes dy institucioneve. Dy institucionet marrin përsipër të bashkëpunojnë në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor mbi bazën e interesave të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi në të dy vendet. Për aq sa është e mundur, të dy universitetet do të inkurajojnë kontaktet e drejtpërdrejta dhe bashkëpunimin e drejtë ndërmjet anëtarëve të personelit akademik të fakulteteve, departamenteve, institucioneve kërkimore dhe studentëve.

Neni 1
Qëllimi i bashkëpunimit

Universiteti Mesdhetar dhe Universiteti "Ismail Qemali", bien dakort të zhvillojnë aktivitetet në fushat akademike me interes të përbashkët duke u bazuar në principet e barazisë dhe reciprocitetit.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushat e bashkëpunimit mes dy universiteteve mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- a) Shkëmbim të personelit akademik për zhvillime leksionesh speciale nga autoritetet shkencore, në ciklet e ndryshme universitare nga niveli bachelor deri në studimet doktorale.
- b) Shkëmbim të studentëve;
- c) Promovime dhe publikime të përbashkëta në kërkimin shkencor;
- ç) Shkëmbim i materialeve akademike si revistat shkencore dhe i informacioneve të tjera të nevojshme;

- d) Bashkëpunimi profesional dhe shkencor për publikimin e revistave shkencore dhe të botimeve të veçanta si edhe literaturës së duhur, të kërkuar nga profesorët, studentët dhe nga lexuesit e tjerë.
- dh) Organizime dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore, veprimtari, seminare dhe takime akademike dhe kërkimore e shkencore.
- e) Bashkëorganizim të programeve të trajnimit afatshkurtër;
- f) Organizim dhe pjesëmarrje në programe të veçanta akademike afatshkurtra.

Neni 3 Zbatimi

Kushtet dhe mënyra e bashkëpunimit për secilin prej aktiviteteve të lartpërmendura që do të implementohen në bazë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të diskutohen, vendosen dhe nënshkruhen me shkrim përpara fillimit të aktivitetit.

Neni 4 Rinovimi, përfundimi dhe amendimet

- a) Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të jetë në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, prej datës së nënshkrimit nga të dyja palët, me mirëkuptimin që mund të përfundoj edhe përpara këtij afati me iniciativën e njerës prej palëve, duke njoftuar me shkrim 6 muaj më parë. Gjithashtu, kjo marrëveshje mund të shtyhet në afat apo ndryshohet në afat apo ndryshohet në pjesë të veçanta të saj, nëse të dy palët bien dakort me shkrim.
 - b) Pikat, të cilat nuk janë mbuluar nga marrëveshja, mund të përcaktohen dhe negociohen në mënyrë të veçantë nga të dy institucionet, pa qenë e nevojshme të shfuqizojnë këtë marrëveshje.
- Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet me pëlqimin e të dy palëve.

Neni 5

Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje, nga 1 (një) për secilën palë nënshkruese.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Prof.Dr Adrian CIVICI
REKTOR



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Prof.Dr Roland ZISI
REKTOR

